




Udhëzuesi për reintegrimit



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government



Informata te përgjithshme

Riatdhesimi ndodh kur personi e humb ose nuk ka bazën ligjore për qëndrim në vend të huaj dhe duhet të kthehet në vendin e tij/saj të origjinës. Personi e humb ose nuk ka bazën ligjore për qëndrim në shtetin e huaj nëse i skadon viza dhe nuk i zgjatet, nëse i refuzohet kërkesa për azil, nëse ai apo ajo ka hyrë ilegalisht në një shtet ose i është anuluar leja e qëndrimit.

Nëse do të riatdhesoheni ose jeni riatdhesuar ne Kosovë, është me rëndësi për ju ta dini, që nuk jeni vetëm dhe do të ndihmoheni në organizimin e integritit tuaj të serishëm në shoqërinë kosovare.

Qëllimi i kësaj fletëpalosjeje është, që të ju informojë për të drejtat dhe mundësitë tuaja në Kosovë dhe të ju jep udhëzime praktike për atë se kujt/cilës zyre t'i drejtoheni për qasje në shërbime publike. Informatat e dhëna në këtë fletëpalosje nuk janë përfundimtare dhe inkurajoheni që t'i qaseni institucioneve të përmendura në këtë fletëpalosje, në mënyrë që të merrni më shumë informata për mundësitë e ofrimit të ndihmës për ju. Në përgjithësi, **Zyra Komunale për Komunitete dhe për Kthim (ZKK)** në komunën tuaj është pika e parë e kontaktit dhe nëpunësit e kësaj zyre do të ju drejtojnë në adresën e duhur.

Nëse nuk keni arritur në Kosovë akoma, ju lutemi të merrni të gjitha dokumentet tuaja personale që i keni në dispozicion, në mënyrë që ta lehtësoni regjistrimin e gjendjes tuaj civile në Kosovë dhe t'i bëni të vlefshme dokumentet tuaja. Në këto dokumente përfshihen dokumentet e identifikimit, certifikatat e lindjes të të gjithë anëtarëve të familjes (posaçërisht atyre që kanë lindur jashtë Kosovës), certifikatat e martesës, certifikatat shëndetësore, arsimore, posaçërisht certifikatat dhe diplomat e shkollës për ju dhe fëmijët tuaj, dokumentet lidhur me punësim dhe pension, dokumentet e pronësisë, dhe dokumente të tjera të cilat mendoni se janë të rëndësishme.

Transporti në komunën e origjinës dhe strehimi i përkohshëm: kush do të ju ndihmojë me rastin e ardhjes tuaj në Kosovë?

Me të arritur në Kosovë, ju do të pajiseni me informata fillestare për shërbimet publike që do ta lehtësojnë ri integrimin tuaj të menjëhershëm në komunën tuaj të origjinës. Zyrtarët e Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale (MPMS) janë të pranishëm në Aeroportin e Prishtinës (pasi ta kaloni imigracionin) dhe do të ju ndihmojnë në organizimin e hapave tuaj të mëtejshëm.

Roli dhe përgjegjësia e MPMS në pritje të të kthyerve në aeroport është:

- pritja dhe regjistrimi i të kthyerve,
- transportimi deri në komunën e origjinës për personat që nuk kanë mundësi transporti
- strehimi afat shkurtër (1 deri në 7 ditë) në qendrën e përkohshme për ata që nuk kanë ku të shkojnë

Luteni që t'i afroheni zyrtarëve të MPMS-së që janë të pranishëm në aeroport për asistencë. Për më tepër, ekipi mjekësorë i Ministrisë së Shëndetësisë (MSH) është i pranishëm në aeroportin e Prishtinës, nëse ju nevojitet ndihmë e menjëhershme mjekësore me rastin e arritjes suaj.

Gjendja civile dhe regjistrimi: ku mund te regjistroni gjendjen tuaj civile dhe si mund të pajiseni me dokumentet civile?

Regjistrimi i gjendjes suaj civile dhe e familjes tuaj është parakusht themelor për qasjen në kujdes shëndetësorë, punësim, mirëqenie sociale, pension, pronë dhe shërbimet te tjera.

Faza e parë : regjistrimi i gjendjes suaj civile

Me kthimin tuaj në komunën e origjinës domethënë ku keni qenë i regjistruar para largimit nga Kosova, duhet të shkoni në **Zyrën komunale të gjendjes civile**, kjo zyre është përgjegjëse për regjistrimin e vendbanimit tuaj. Kjo zyre merret me regjistrimin e gjendjes civile, që do të thotë, regjistrimi i të gjitha lindjeve, martesave, vdekjeve në regjistrat e gjendjes civile dhe do të ju lëshojë certifikata për gjendjen tuaj civile. Nëse kjo zyre e refuzon regjistrimin tuaj në librat amzë, keni të drejtë të ankoheni në komisionin për ankesa dhe parashtresa pranë Ministrisë së Punëve të Brendshme në Agjencinë e Regjistrimit Civil (ARC) ose përmes komunës tuaj të origjinës.

Faza e dytë : pajisja me dokumentet civile

Pasi pajiseni me certifikatën e lindjes, certifikatën e statusit martesor, certifikatën e shtetësisë të lëshuar nga Zyra komunale e gjendjes civile, duhet të shkoni në **Qendrën komunale të regjistrimit civil (QKRC)**. Kjo zyre është përgjegjëse, për lëshimin e letërnjoftimit dhe pasaportës.

Çka duhet të bëni nëse nuk posedoni ndonjë lloj të dokumenteve civile personale?

Duhet të shkoni në **Zyrën komunale të gjendjes civile** dhe zyrtarët do t'ju informojnë për mundësitë tjera të marrjes së dokumenteve civile.

Kujdesi shëndetësor: ku mund të shkoni nëse keni probleme shëndetësore?

Pika e parë e kontaktit për çdo ndihmë të kujdesit mjekësorë janë qendrat më të afërta të kujdesit shëndetësorë parësor (KPSH) (ish Ambullantat), në komunën tuaj. Nëse kujdesi parësor shëndetësorë nuk është në gjendje t'ju ofroj trajtimin e kërkuar, atëherë ajo do t'ju udhëzojë për në kujdesin dytësor shëndetësor në spitalet rajonale.

Në rast se spitali rajonal nuk mund të ofrojë ndihmën e kërkuar mjekësore, duhet të ju udhëzojë në kujdesin terciar shëndetësor tek Qendra Klinike Universitare në Prishtinë. Në rast të ndonjë sëmundjeje të rëndë, e cila nuk mund të trajtohet në Kosovë, ekziston programi mjekësorë për trajtim jashtë institucioneve publike. Në raste urgjente, personi duhet të dërgohet në institucionin e kujdesit shëndetësorë më të afërt ose në institucionin që konsiderohet të jetë më i duhuri.

Sipas legjislacionit të Kosovës, institucionet e shëndetit publik ofrojnë shërbime shëndetësore falas grupeve të veçanta siç janë: gratë shtatzëna, fëmijët dhe të rinjtë deri në moshën 15 vjeç, qytetarët mbi moshën 65 vjeçare, familjet të cilat marrin ndihmë sociale, personat me aftësi të kufizuara, etj.

Nëse ju apo familja juaj përballeni me ndonjë vështirësi gjatë qasjes në kujdesin shëndetësorë ose nëse keni ndonjë pyetje për kujdesin shëndetësorë në përgjithësi, për ndihmë mund të kontaktoni **drejtorinë komunale e shëndetësisë dhe/ose mirëqenies sociale**.

Arsimi: si mund t'i qaseni sistemit arsimor në Kosovë?

Jeni të obliguar t'i regjistroni fëmijët tuaj në shkollë pasi t'i kenë mbushur 6 vjet. Shkollimi i detyruar fillon me fillimin e vitit shkollor pasi që fëmija t'i mbushë 6 vjet dhe mbaron me përfundimin e vitit të nëntë të shkollimit nga data e regjistrimit në arsimin fillor ose në datën kur nxënësi i mbush 15 vjet. Për të gjithë fëmijët nga klasa 1 – 9, Qeveria e Kosovës për çdo vjet siguron tekstet shkollore falas.

Për regjistrimin e fëmijëve tuaj në arsimin parauniversitar (parafillor, arsim fillor, arsim të mesëm të ulët dhe arsim të mesëm të lartë), duhet të shkoni në **Departamentin komunal për arsim** në komunën tuaj.

Është me rëndësi të sillni diplomat dhe/ose certifikatat e vijimit të shkollimit në vendin prej nga keni ardhur, përndryshe mungesa e këtyre dokumenteve do të ju sjellë vështirësi si juve ashtu edhe fëmijëve tuaj.

Fëmijët tuaj do të sistemohen në nivelin apo klasën përkatëse deri sa të vlerësohet dokumentacioni (diplomat apo certifikatat) nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT) me ndërmjetësimin e Departamentit komunal të arsimit.

MASHT, Komunitat dhe Qendrat për Aftësi Profesionale do t'iu ofrojnë të interesuarve të moshave të ndryshme edhe arsimim profesional varësisht prej kërkesave dhe nevojave të tyre. MASHT dhe komunitat do të ofrojnë arsimim special për fëmijët me nevoja të veçanta në kushte të barabarta me fëmijët tjerë që jetojnë në Kosovë. Shkolla, Komunitat dhe MASHT sigurojnë kurse të gjuhës amtare dhe nëse ka nevojë do të organizohen edhe orë plotësuese. Për komunitetet jo shumice që gjuha mësimore nuk përputhet me gjuhën amtare të tyre, do të organizohen orë shtesë për mësimin e gjuhës mësimore që ata e zgjedhin për ta vijuar shkollimin.

Punësimi: ku mund të regjistroheni si punëkërkes?

Gjetja e punës ose krijimi i vetë-punësimit që përshtatet me aftësitë dhe përvojën është pjesë integrale e ri integritit tuaj si dhe do t'ju ofrohet mbështetje në mënyrë që ju të arrini sukses.

Nëse kërkon punë, duhet të regjistroheni në **Qendrën Rajonale për Punësim ose Zyrën më të afërt Komunale për Punësim**. Zyra Komunale ose Qendra Rajonale për Punësim do t'ju mbështesë përmes këshillave profesionale, udhëzojë për oferta pune (përshtatje të vendit të punës), dhe do t'ju udhëzojë tek qendrat për aftësim profesional. Për më tepër, regjistrimi do t'ju lejoj më tutje që të kërkon mbështetje sociale (shih paragrafin për mirëqenie sociale).

Aftësimet profesionale ofrohen për një spektër të gjerë të fushëveprimeve dhe janë në dispozicion për të gjithë qytetarët e Kosovës, të cilët janë të regjistruar si të papunë.

Mirëqenia sociale: si mund të përfshihen në skemat sociale?

Pasi që ta regjistroni gjendjen tuaj civile dhe atë të familjes suaj, ju keni të drejtë të përfitoni nga skema për mirëqenie sociale në Kosovë. Skemat nga Ministria e Punës dhe e Mirëqenies Sociale ku ju mund aplikoni janë:

- ndihma sociale
- pensionet për familjet e Dëshmorëve, viktimave civile të luftës
- pensioni bazë,
- pensioni për personat me aftësi të kufizuara
- Ndihma materiale për familjet që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara të përhershme

Për skemat e sipërshënuara ju mund të paraqiteni nëpër zyrat më të afërta Komunale varësisht nga skema ku ju mund të aplikoni .

Çdonjëri që është në moshën 65 vjeç ose më i vjetër dhe qytetar i regjistruar i Kosovës ka të drejtë të marrë pensionin bazë prej 40 euro në muaj. Nëse i plotësoni kërkesat dhe dëshironi të merrni pension bazë, duhet të shkoni në **Zyrën komunale të divizionit për pensione dhe përfitime** nga MPMS.

Secili që nuk është i aftë të punojë (ndërmjet moshës 18 dhe 65 vjeçare) ka të drejtë të aplikoj për pension për personat me aftësi të kufizuara prej 40 euro në muaj. Të rriturit me paaftësi të përhershme dhe që janë të paaftë për punë duhet të sigurojnë vërtetim për paaftësinë e tyre nga mjeku që i ka kontrolluar. Për më tepër, familjet e fëmijëve me aftësi të kufizuara të përhershme kanë të drejtë të pranojnë mbështetje financiare. Për me shume hollësi, luteni të shkoni në **Zyrën komunale të divizionit për pensione dhe përfitime** ose në **Qendrën për Pune Sociale** më e afërt.

Ekzistojnë dy kategori të ndihmës sociale që ofrohen në Kosovë:

- Ndihma sociale për familjet pa asnjë burim të të ardhurave dhe me anëtarë të familjes që nuk janë të aftë të punojnë (kërkohet vërtetim për aftësi të kufizuara për të gjithë anëtarët e familjes prej moshës 15-65 vjeçare).
- Ndihma sociale për familjet pa asnjë burim të të ardhurave, të cilët nuk marrin asnjë ndihmë nga ndonjë anëtarë i familjes që punon në Kosovë ose jashtë saj, ose ndonjë anëtarë i familjes që është i aftë për të punuar (nevojitet vërtetim nga zyra për punësim).

Qendra për Pune Sociale më e afërt dhe/ose **Zyra komunale e divizionit për pensione dhe përfitime** do të jetë në gjendje të përcaktojë nëse anëtarët e familjes suaj kanë të drejtë të përfshihen në skemën e tillë të ndihmës sociale dhe t'ju ndihmojë për ndonjë çështje tjetër.

Banimi social dhe prona: si mund të zgjidhni çështjen e banimit tuaj?

Çështja e banimit për ju dhe familjen tuaj është pjesë integrale e procesit të ri-integrimit në komunën tuaj të origjinës. Para kthimit tuaj në Kosovë, komuna e juaj e origjinës do të informohet për nevojat tuaja speciale për banim dhe ka përgjegjësi të identifikojë pronën tuaj të paluajtshme dhe/ose te ju ofroj strehimin.

Kujt t'i drejtoheni për pronën tuaj të okupuar/uzurpuar?

Agjencia Kosovare e Pronës (AKP) ka mandatin të pranojë, regjistrojë dhe të zgjidhë kërkesat të cilat janë si pasojë e konfliktit të viteve 1998-1999, në lidhje me pronën e paluajtshme private, përfshirë pronën bujqësore dhe komerciale. Afati për pranimin e kërkesave për ri-posedim nga ana e AKP-së ka filluar me 5 prill 2006 dhe ka përfunduar me 3 dhjetor 2007.

- Në rast se ju keni humbur posedimin e pronës suaj si rezultat i konfliktit të viteve 1998-1999, dhe keni plotësuar një kërkesë pranë Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP) për ri-posedim, atëherë AKP do të ju ndihmojë të ktheni posedimin e pronës suaj
- Nëse nuk keni bërë kërkesë për ri-posedim deri më datën 3 dhjetor 2007, atëherë, ju duhet t'i drejtoheni gjykatave të rregullta komunale me padi për ri-posedim d.m.th padi për pengim të posedimit të pronës.

Vendimet e marra nga Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK-ja) janë lëndë e të drejtës së ankesës vetëm para Gjykatës Supreme të Kosovës.

Ju keni bërë kërkesë për ri-posedim të pronës pranë AKP-së por ende nuk keni marrë vendimin; kujt t'i drejtoheni?

Luteni që t'i kontaktoni zyrën regionale më të afërt të AKP-së dhe kërkon informata shtesë, në lidhje me statusin e lëndës tuaj. Nëse vendimi i AKP-së është në favorin tuaj, atëherë AKP-ja do të përshpejtojë procedurat për dëbimin e banorëve të paligjshëm. Nëse prona juaj është dëmtuar pasi që AKP-ja ka dëbuar nga prona banorët e paligjshëm, ju duhet ta paraqitni rastin tek Policia e Kosovës (PK) e cila sipas detyrës zyrtare rastin duhet ta paraqes në gjykatë. Nëse PK nuk e paraqet rastin në gjykatë për çfarëdo lloj arsye, ju mund ta paraqitni rastin vetë, të bëni padi private në gjykatë për dëmtim të pasurisë. **Zyrat regionale të AKP-së** gjinden në këto komuna: Prishtinë/Priština, Pejë/Peć, Mitrovicë/Mitrovica, Gjilan/Gnjilane dhe Prizren



Nëse posedoni me dëshmi të së drejtës pronësore të vërtetuar nga organet kompetente të Kosovës, si mund ta regjistroni pronën në emrin tuaj?

Nëse keni vendim nga gjykata, dokumentet kadastrale, faturat apo ndonjë testament të vërtetuar ligjërisht, atëherë vizitoni **Zyrën Kadastrale të Komunës** suaj e cila është përgjegjëse për regjistrimin e pronës së paluajtshme. Zyra Kadastrale do ju ndihmojë rreth regjistrimit të pronës suaj. Nëse statusi i pronës që ju kërkoni del të jetë i diskutueshëm, atëherë ju duhet t'i drejtoheni Gjykatës Komunale dhe të ngrehni një padi për vërtetimin e pronësisë.

Nese prona juaj është marrë nga autoritetet publike-shtetërore pa kompensim, kujt t'i drejtoheni?

Atëherë, vizitoni Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim të cilët do të ju tregojnë te kush dhe ku mund te drejtoni ankesën tuaj. .

Nëse nuk keni shtëpi dhe nuk keni ku të strehoheni, kush mund të ju ndihmoj për zgjidhjen e çështjes së banimit?


Për familjet që nuk kanë mundësi të zgjedhin çështjen e banimit vet janë tri mundësi:

- Përfshirja në skemat e qirasë për pronat që janë nën pronësi private me kontratë paraprake me komunat ose nën menaxhim të AKP-së.
- Përfshirja në programet e banimit social të komunës suaj të origjinës në bashkëpunim me Qeverinë ose donatorët
- Rindërtimi i shtëpive të vogla në tokën në pronësi të vet personave të riatdhesuar

Për të marre më shumë informata rreth asistencës që mund të ofrohet, drejtohuni në **Drejtorinë për mirëqenie sociale** ose **Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim**.



Shtojca I – Informatat kontaktuese me komunat



	Komuna	Adresa	Nr. telefonit
1.	Deçan/Deçane	Sheshi Mentor Tolaj	+381 (0) 390 361 100
2.	Dragash/Dragaš	Rr. Sheshi i Dëshmoreve	+381 (0) 29 281 005
3.	Ferizaj/Uroševac	Rr. Dëshmoret e Kombit,	+381 (0) 290 320 150
4.	Fushë Kosovë/ Kosovo Polje	Rr. Nëna Terezë	+381 (0) 38 536 006
5.	Gjakovë/Đakovica	Rr. Nëna Terezë, Nr. 469	+381 (0) 390 321 100
6.	Gjilan/Gnjilane	Ndërtesa e Kryetarit, Rr. Adem Jashari, Ndërtesa e ekzekutivit komunal, Sheshi Rexhep Mala e Nuhi Berisha,	+381 (0) 280 323 311; +381 (0) 280 226 428; Numri i Ekzekutivit: +381 (0) 280 320 490
7.	Gllgovc/Glogovac	Rr. Fehmi e Xhevë Lladrovci	+381 (0) 38 584 074
8.	Gračanicë/Gračanica	Dukat Hotel, rruga kryesore	s'ka numër telefoni
9.	Han i Elezit/Đeneral Janković	Rr. Nuri Bushi	+381 (0) 290 385 112; +377 (0) 44 381 314
10.	Istog/Istok	Rr. 2 Korriku	+381 (0) 39 451 202
11.	Junik/Junik	Qendër (pa numër)	+381 (0) 390 370 114
12.	Kaçanik/Kačanik	Rr. Emin Duraku	+381 (0) 290 380 005; +381 (0) 290 380 047; +377 (0) 44 225 315
13.	Kamenicë/Kamenica	Ndërtesa Kriva Reka, Rr. Skënderbeu (pa numër), Zyrtari Komunal i Kthimit: lokalet e Shtëpisë së Kulturës Isa Kastrati, Rr. Skënderbeu	Zyra e Kryetarit: +381 (0) 280 371 969
14.	Klinë/Klina	Rr. Abedin Rexha	+381 (0) 39 471 306
15.	Kllokot/Klokot	Vërboc, Kllokot (pa emër rruge apo numër)	Zyra e Kryetarit: +381 (0) 280 385 470
16.	Leposavić/Leposaviq	Rr. JNA, Zyra Komunale e Komuniteteve: Haki Imeri, Shef, fshati Bistricë	+381 (0) 28 83 860
17.	Lipjan/Lipljane	Rr. Shqipëria	+381 (0) 38 581 255; +381 (0) 581 258 dhe +381 (0) 581 505
18.	Malishevë/Mališevo	Rr. Gjergj Kastrioti Skënderbeu	+381 (0) 29 269 043
19.	Mamusa/ Mamushë/ Mamuša	Ndërtesa komunale në sheshin kryesor	+381 (0) 29 273 260
20.	Mitrovicë/Mitrovica	Rr. Mbretëresha Teutë, (pa numër) Zyra Komunale e Kthimit Rr. Mbretëresha Teutë, (pa numër)	+381 (0) 28 532 104

21.	Novo Brdo/Novobërdë	Fshati Bostan (pa emër rruge apo numër)	+381 (0) 38 576 012 Zyra e Kryetarit: +381 (0) 38 576 009
22.	Obiliq/Obilić	Rr. Hasan Prishtina, (pa numër) Obiliq	+381 (0) 38 561 536
23.	Parteš/Partesh	Komuna ende nuk është funksionale	kontakti për Ekipin Komunal +377 (0) 45 386 489
24.	Pejë/Peć	Rr. Mbretëresha Teuta, Nr. 59	+381 (0) 39 432 875; +381 (0) 39 434 875
25.	Podujevë/Podujevo	Rr. Zahir Pajaziti	s'ka numër telefoni
26.	Prishtinë/Priština	Rr. UCK, Nr. 2, 10000	s'ka numër telefoni
27.	Prizren	Ndërtesa kryesore komunale (ZKK/ZKK), Rr. Remzi Adem; Ndërtesa Komunale Shtëpia e Bardhë (Z/ Kryetari për komunitete, Zv. Kryesuesi i Kuvendit për komunitete), Rr. Adem Jashari	+381 (0) 29 241 925; Zyra e Kryetarit: +381 (0) 29 242 406
28.	Ranilug/Ranillug	Fshati Ropotovë e Madhe (pa emër rruge apo numër)	+381 (0) 280 76 010; Zyra e kryetarit: +381 (0) 280 375 422;
29.	Rahovec/Orahovec	Ndërtesa e re e komunës (Zv. Kryetari për komunitete, Shefi i ZKK Rr. Xhelal Hajda – Toni	+381 (0) 29 276 037; +381 (0) 29 276 737; +381 (0) 29 276 039
30.	Štrpce/Shtërpçë	Štrpce/Shtërpçë (pa emër apo numër rruge)	Sekretarja e Kryetarit: +381 (0) 290 370 005
31.	Shtime/Štimlje	Rr. Tirana	s'ka numër telefoni
32.	Skenderaj/Srbica	Rr. 18 Qershori ZKK, pa adresë Fshati Bajë	+381 (0) 28 582 124
33.	Suharekë/Suva Reka	Ndërtesa kryesore (MË GR, CC) magjistralia Prishtinë -Prizren. Ndërtesa e vjetër komunale, në breg të lumit (zyra ZKK)	s'ka numër telefoni
34.	Viti/Vitina	Rr. 28 Nëntori	Zyra e Kryetarit: +381 (0) 280 381 626
35.	Vushtrri/Vučitrn	Rr. Adem Jashari, (pa numër) ZKK në fshatin Prelluzhë	+381 (0) 28 571 408; +381 (0) 28 571 524
36.	Zubin Potok/Zubin Potok	Rr. Kolasinskih Knezeva, Nr. 27 ZKK fshati Çabër	+381 (0) 28 460 048
37.	Zvečan/Zvečan	Mbreti Milutin 5 ZKK në fshatin Lipë	+381 (0) 28 664 728

